



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2546 prot.

Tiranë, më 7.07.2023

VENDIM

Nr. 56, datë 07.07.2023

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 181, DATË 11.09.2017
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NGA
KËSHILLI I ANKESAVE DHE TË DREJTËN E PËRGJIGJES”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” dhe nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 181, datë 11.09.2017 të AMA-s “Për miratimin e rregullores për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - 1.1.1. Neni 6 i rregullores riformulohet si më poshtë:

“Neni 6

Konkluzionet e Këshillit të Ankesave

1. *Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës jo më vonë se 30 ditë nga data e depozitimit të saj.*
2. *Vendimi i Këshillit të Ankesave duhet të jetë i argumentuar. Ai duhet të përmbajë:*
 - a) *objektin e verifikimit;*
 - b) *pretendimet e ngritura nga ana e palës ankuese;*
 - c) *pretendimet apo arsyetimet e mundshme të OSHMA-së;*
 - d) *referencë të dokumenteve që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standardeve profesionale;*
 - e) *përmbledhjet e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;*

- f) përfundimet nëse në rastin konkret janë konstatuar shmangie apo shkelje të ligjit, si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkak për masë paralajmëruese apo për vendosjen e sanksioneve ndaj OSHMA-së;
- g) propozimin për AMA-n lidhur me vendosjen e sanksioneve ndaj OSHMA-së.
3. Në çdo rast, Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHMA-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat e propozuara.
4. Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shmangie, cakton masën paralajmëruese "Tërheqje vëmendje" për OSHMA-në dhe kërkon ndreqjen e shmangies nga kërkesa ligjore përkatëse brenda një afati 30 ditor.
- a) Mosndreqja e shmangies nga kërkesa ligjore përkatëse brenda një afati 30 ditor çon automatikisht në marrjen e masave sipas nenit 133 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar.
- b) Më shumë se tri shmangie me të njëjtin objekt brenda të njëjtit vit kalendarik çojnë automatikisht në marrjen e masave sipas nenit 133 të nenit nr. 97/2013, të ndryshuar.
5. Referuar pikës 4 të këtij neni, Këshilli i Ankesave informon periodikisht dhe rast pas rasti AMA-n mbi masat paralajmëruese "Tërheqje vëmendje" të vendosura ndaj OSHMA-ve. Informacioni përcillet pa vonesë nga Sekretariati Teknik në adresat zyrtare elektronike të anëtarëve të AMA-s.
6. Pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të OSHMA-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, propozon pranë AMA-s marrjen e masave, në përputhje me nenin 133 të ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar."
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Armela	KRASNIQI
Zëvendëskryetar:	Desada	METAJ
Anëtarë:	Aurela	BICJA
	Besian	ZOGAJ
	Gjergji	HAMITI
	Jetmir	HALILAJ
	Joana	ALLUSHI